

Qeveria malazeze dhe Bashkësia Islame kanë arritur marrëveshje për të avancuar edhe më tej marrëdhëniet e tyre.

Myslimanëve në Mal të Zi edhe ligjërisht iu është dhënë e drejta që çdo të premtë, saktësisht në mesditë, t'i ndalojnë të gjitha aktivitetet dhe t'i përkushtohen namazit qendror - lutjeve të Xhumasë, të bartin kudo kapele dhe shamitë tradicionale, me të cilat mund të fotografohen për dokumente personale, por edhe që, përmes Bashkësisë Islame të krijojnë shkollat e tyre, ndërsa në institucionet publike të ushtrojnë të drejtën e tyre për ushqim të veçantë.

Kjo marrëveshje është nënshkruar nga kryeministri malazez Igor Lukshiq dhe kryetari i Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Rifat Fejziq, transmeton Telegrafi.

Ndërkaq, edhe veshjet tradicionale fetare do të mund të barten edhe në ushtrinë malazeze, e cila deri më tani nuk ishte e lejuar.

Kurse rreth restaurimit të objekteve fetare, si dhe ligji rreth trashëgimisë familjare, do të miratohet pas marrjes së bekimit nga komisioni, që do të përbëhet nga dy palët.